



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

EC MA NDRYSHE RAPORT VJETOR I PUNËS 2014

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V), 10000/Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

EC MA NDRYSHE

Organizata jo-qeveritare “EC Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t’i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014 – 2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014), Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2015), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Ku është kalldrëmi i Prizrenit (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim? (2014), Dokumentari - Sa aktiv, aq transparent? (2014), Udhëzues për Transparencën në Komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit–zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Transparency”: 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).

PROGRAMET

Që nga themelimi më 2006, EC Ma Ndryshe ka qenë aktivisht e përfshirë në përforsimin e qytetarisë aktive për të ndikuar në politikat publike në nivel lokal (komunën e Prizrenit), me fokus të veçantë në politikat kulturore. Organizata synon arritjen e një qytetarie të përgjegjshme në nivel lokal dhe shfrytëzimin e kulturës si mjet të zhvillimit lokal ekonomik. Gjatë vitit 2014, EC Ma Ndryshe ka operuar me dy programe kryesore: pjesëmarrjen qytetare dhe trashëgiminë kulturore. Puna e organizatës fokusohet në tri nivele të veprimit: adresimi i politikave publike, mobilizimi i komunitetit dhe përdorimi i mjeteve të intervenimit direkt për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore. Strategjia e punës përdor qasjen trekëndëshe kulturore – pjesëmarrje – zhvillim. Kjo qasje e sheh kulturën si burim për t'u shrytëzuar, pjesëmarrjen si metodë veprimi, derisa zhvillimin ekonomik si rezultat të dëshiruar.

Programi i Trashëgimisë Kulturore

EC Ma Ndryshe është organizatë e profilizuar në trashëgimi kulturore. Nga themelimi më 2006, organizata është dëshmuar me veprime konkrete në emër të promovimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të Kosovës, me fokus në qytetin e Prizrenit. Si rezultat i performancës së saj, EC Ma Ndryshe përfaqëson Kosovën në rrjetin më të suksesshëm rajonal të trashëgimisë kulturore South East European Heritage Network (www.seeheritage.org). Angazhimi qendror i organizatës në fushën e trashëgimisë kulturore është promovimi i kësaj trashëgimie duke e nxjerrë në pah potencialin zhvillimor të saj.

EC Ma Ndryshe ka përcaktuar këto objektiva afat-mesme të veprimit të saj në trashëgimi kulturore në komunën e Prizrenit:

- Miratimi i të gjitha akteve ligjore nga Kuvendi Komunal i Prizrenit për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore,
- Integrimi substancial i komponentës së trashëgimisë kulturore në planifikimin e zhvillimit (Plani Zhvillimor Komunal, Plani Zhvillimor Urban dhe Planet Rregulluese Urbane),
- Rritja e kapaciteteve të shoqërisë civile (dhe komunitetit) për veprime direkte në mbrojtje të trashëgimisë kulturore,
- Rritja ekonomike bazuar në turizmin kulturor (specifikisht turizmin e trashëgimisë kulturore),
- Krijimi i mekanizmave alternativë për decentralizimin e vendimmarrjes në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Programi i Pjesëmarrjes Qytetare

EC Ma Ndryshe angazhohet për ndryshimin e kulturës politike të shoqërisë kosovare, përmes ndryshimit të qasjes së qytetarit ndaj autoritetit shtetëror. Ky transformim mund të arrihet përmes fuqizimit të rolit të qytetarëve në procese vendimmarrëse. Konkretisht, EC Ma Ndryshe angazhohet për krijimin dhe avansimin e mekanizmave ligjorë të pjesëmarrjes, rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës institucionale në vendimmarrje dhe tejkalimin e barrierave psikologjike të shoqërisë në raport me autoritetet shtetërore. Niveli lokal i angazhimit për aktivizëm qytetar i jep organizatës një përparësi të theksuar veprimi, dhe mundësi më të mëdha në arritjen e rezultateve dhe ndryshimeve konkrete.

EC Ma Ndryshe ka përcaktuar këto objektiva afat-mesme të veprimit të saj në pjesëmarrjen qytetare në komunën e Prizrenit:

- Miratimi i të gjitha akteve ligjore rreth pjesëmarrjes qytetare nga Kuvendi Komunal i Prizrenit,
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e konsultimeve publike,
- Intensifikimi i përdorimit të mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë,
- Rritja e nivelit të transparencës komunale në raport me vendimmarrjen dhe implementimin e politikave,
- Krijimi i mekanizmave alternativë për decentralizimin e vendimmarrjes në fushën e kulturës.

PROJEKTET

Gjatë vitit 2014 EC Ma Ndryshe ka realizuar shtatë projekte. Disa nga projektet kanë vazhduar nga vitet e kaluara, ndërsa disa të tjera do të vazhdojnë të zbatohen edhe gjatë vitit 2015. Projektet e organizatës gjatë vitit 2014 kanë patur këtë shtrirje gjeografike brenda Kosovës: Prizren, Mamushë, Malishevë, Suharekë, Dragash, Rahovec, Gjilan dhe Prishtinë.

Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës

Gjatë vitit 2014, projekti është zgjeruar me komponentën e Prishtinës, ku në fokus ishte planifikimi urban dhe trashëgimia kulturore. Edhe sivjet, projekti i Transparencës Online ishte aktiviteti qendror i mbikëqyrjes ndaj qeverive lokale. Si rezultat i aktivitetit monitorues dhe mbikëqyrës në tri komunitetë përkatëse, një numër i madh informacionesh janë prodhuar në formë të komunikatave dhe analizave. Në Prizren, projekti ka publikuar të gjetura mbi një numër sferash të vendimmarrjes, përfshi planifikimin urban, trashëgiminë kulturore, arsimin, prokurimin publik, shpenzimet buxhetore, etj. Në Mamushë është monitoruar vendimmarrja e ekzekutivit, duke sjellë dritë mbi menaxhimin e parasë publike. Ndërsa në Prishtinë projekti është fokusuar në ndërtimet pa leje dhe degradimin e trashëgimisë publike.

Të arriturat kryesore të projektit gjatë vitit 2014 ishin:

- Hapja e vendimmarrjes së ekzekutivit, duke e ndryshuar praktikën e mbyllur të takimeve të Kryetarit të Komunës së Prizrenit,
- Transparenca e rritur fiskale përmes publikimit të rregullt të shpenzimeve buxhetore të komunës së Prizrenit,
- Themelimi i Forumit Transparenca, si trup i përbashkët veprimi i aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve të Prizrenit,
- Adresimi i një numri rastesh të parregullsive të komunës së Prizrenit tek qeveria qendrore dhe institucionet e gjyqësisë,
- Nxitja e veprimit institucional për të trajtuar sfidat e Qendrës Historike të Prishtinës përmes publikimit të rasteve të degradimit dhe avokimit të përhershëm,
- Dokumentimi i rasteve të ndërtimeve pa leje (dhe parregullsive tjera urbane) në lagjet e Prishtinës si parakusht për ndërtimin e strategjisë për trajtimin e ndërtimeve pa leje (përkrahje për procesin e legalizimeve),
- Përditësimi i rregullt i web-faqes së transparencës, e cila është shndërruar në hub të transparencës lokale dhe i shërben një numri të madh përfituesish.

Qyteti Gjithëpërfshirës – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren

Në mungesë të kapaciteteve të komunës së Prizrenit për t'i organizuar konsultimet publike për planifikim urban, projekti ka siguruar përfshirje të një numri të madh qytetarësh në identifikimin e nevojave dhe përkthimin e tyre në plane të zbatueshme urbane të Prizrenit. Përmes targetimit të grupeve të nënpërfaqësuar të komunitetit (të moshuarit, gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, lagjet e varfra, etj.), projekti ka lehtësuar komunikimin e tyre me politikëbërësit komunalë. Përveç veprimeve të mobilizimit dhe zhvillimit komunitar, projekti ka realizuar edhe një numër performansash publike, të cilat kanë shërbyer si përkujtues për obligimet e komunës ndaj qytetarëve dhe në të njëjtën kohë kanë prodhuar zgjidhje konkrete përr problemet ekzistuese në hapësirën publike.

Të arriturat kryesore të projektit gjatë vitit 2014 ishin:

- Përfshirja e qindra qytetarëve në aktivitete që kanë synuar identifikimin e nevojave dhe përkthimin e tyre në plane të zbatueshme urbane,

- Prodhimi i zgjidhjeve dhe vizioneve për trajtimin e sfidave në hapësirën publike të Prizrenit,
- Trajtimi i një numri të rasteve të raportuara nga komuna e Prizrenit, përfshi shtrimin e pjerrinave, eliminimin e pengesave fizike në trotuare, etj.
- Hapja e procesit të vendimmarrjes përmes partneritetit mes drejtorisë së urbanizmit dhe organizatave të shoqërisë civile për organizimin e diskutimeve publike,
- Evidentim i nevojave dhe shqetësimeve të qytetarëve përmes instrumentit të përhershëm të anketimit me mostër të gjerë në qytet (projektimi i trendëve dhe matja e kënaqshmërisë së qytetarëve),
- Përfshirja e të gjeturave nga puna me qytetarët në planin rregullativ të lagjes Arbana.

Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë

Projekti ka ndihmuar Gjykatën Themelore të Prizrenit në strukturimin e njësisë së informimit publik. Konkretisht, gjatë vitit 2014 janë prodhuar disa mjete të komunikimit, përfshi Strategjinë e Komunikimit të Gjykatës (dhe planin e veprimit). Në emër të rritjes së transparencës së Gjykatës, projekti ka ndihmuar në përgatitjen e një spoti informativ televiziv për punën e Gjykatës dhe disa materialeve tjera edukative. Komponentë esenciale e projektit ka qenë edhe lehtësimi i komunikimit të grupeve të komunitetit me shërbyesit e drejtësisë. Disa takime tematike me pjesëmarrje të gjerë janë organizuar për të rritur komunikimin mes qytetarëve dhe Gjykatës, duke e instaluar një praktikë të re në veprimin e këtij institucioni. Zyra për Informim e Gjykatës tashmë operon me një numër mjetesh të përhershme të komunikimit (profillet në mediat sociale, buletini tre-mujor informues, programe 'vizito Gjykatën', etj.)

Të arriturat kryesore të projektit gjatë vitit 2014 ishin:

- Produktet e reja të komunikimit me publikun: spoti televiziv, Strategjia e Komunikimit, buletini tre-mujor informues, programe 'vizito Gjykatën', broshura informuese,
- Rritja e komunikimit mes qytetarëve dhe Gjykatës përmes diskutimeve tematike dhe programeve për të vizituar Gjykatën,
- Transparencë e rritur në punën e Gjykatës si rezultat i krijimit të mjeteve të reja të komunikimit me publikun (informim i rregullt, takime, etj.),
- Konsolidimi i kapaciteteve të Zyrës për Informim përmes përkrajes së rregullt teknike në përpilimin dhe zbatimin e mjeteve të reja të komunikimit me publikun.

Urbanism Watch – urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm

Mbikëqyrja e sektorit të urbanizmit me fokus në Qendrën Historike të Prizrenit ka qenë angazhim qendror i organizatës edhe gjatë vitit 2014. Projekti ka monitoruar gjithë ciklin institucional (qeveri lokale, qeveri qendrore, Kuvend i Kosovës, gjyqësi, polici, etj.) për të sjellë transparencë të shtuar në punën e shtetit në raport me mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit. Shqetësimet e artikuluar rregullisht nga organizata kanë gjetur hapësirë edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2014, ku për herë të parë në mënyrë eksplicite konstatohet dështimi i komunës dhe i qeverisë qendrore për të ofruar mbrojtje adekuate për trashëgiminë kulturore në Prizren. Projekti ka ndikuar edhe në një numër vendimesh dhe veprimesh të komunës së Prizrenit dhe qeverisë qendrore për të vendosur rend dhe ligj në Qendrën Historike të qytetit.

Të arriturat kryesore të projektit gjatë vitit 2014 ishin:

- Transparencë e rritur në vendimeet dhe veprimet institucionale në raport me Qendrën Historike të Prizrenit,

- Themelimi i Task Forcës nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për trajtimin e degradimit urban (ndërtimet pa leje) në Qendrën Historike,
- Dokumentimi i rasteve të ndërtimeve pa leje brenda Qendrës Historike dhe publikimi i rregullt i të gjeturave për të vazhduar presionin ndaj institucioneve të shtetit,
- Strukturimi i komunikimit me Komisionin Evropian që ka ndikuar në pasqyrimin më real të gjendjes së Qendrës Historike në Raportin e Progresit,
- Ndërmarrja e disa veprimeve korrigjuese të komunës së Prizrenit në Qendrën Historike, përfshi lirim të hapësirave publike, largimin e reklamave jashtë kriterëve, kufizimin e qarkullimit të veturave, etj,
- Hetimet e nisura nga Prokuroria Themelore e Prizrenit për rastet e raportuara të degradimit të trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike,
- Zvogëlimi i numrit të ndërtimeve pa leje dhe parregullsive të tjera brenda Qendrës Historike të Prizrenit.

Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren

Gjatë vitit 2014, organizata ka nisur një cikël diskutimesh publike për nevojën e aktivizmit kulturor dhe urban, për të transformuar potencialin kulturor dhe artistik të qytetit në aktivizëm dhe veprim në mbrojtje të qytetit. Komponentë qendrore e projektit ka qenë thirrja për intervenime artistike në hapësirën publike, që synon bartjen e diskutimit mbi degradimin e qytetit në hapësirën publike përmes intervenimeve dhe performansave. Një hulumtim i veçantë gjatë vitit ka vlerësuar potencialin për aktivizëm kulturor në Prizren. Tri vepra të intervenimit artistik në hapësirën publike, publikimi i raportit të hulumtimit dhe konferenca rajonale për aktivizëm kulturor do të realizohen në pjesën e parë të vitit 2015.

Të arriturat kryesore të projektit gjatë vitit 2014 ishin:

- Forume të rregullta diskutimi për të nxitur aktivizmin kulturor dhe urban në Prizren, si reagim ndaj degradimit urban në qytet,
- Promovimi i konceptit të intervenimit në hapësirën publike përmes veprave artistike që do të bartin diskutimin mbi qytetin në hapësirën e Qendrës Historike të qytetit,
- Hulumtimi mbi potencialin e aktivizmit kulturor në Prizren, i cili do të prodhojë rekomandime për qeverinë lokale dhe komunitetin kulturor të qytetit mbi politikën kulturore dhe aktivizmin.

Trashëgimia kulturore shtyllë qendrore e zhvillimit rajonal në Prizren

Pas krijimit të databazës rajonale të trashëgimisë kulturore (2013) dhe zbatimit të pilot veprimit HAJDE (2014), projekti ka hyrë në fazën kulmore dhe në fillim të vitit 2015 pritet prodhimi i Strategisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore. Gjatë vitit 2014, projekti ka vazhduar të ofrojë mundësi për komunitetin që të ndërveprojë me trashëgiminë kulturore në Prizren dhe qytetet e tjera të Kosovës. Aktiviteti qendror i projektit gjatë vitit ka qenë Java e Trashëgimisë Shpirtërore, e cila ka promovuar zejen e filigranit (punëltoria për të rinjtë) dhe ka sjellë praktika të trashëgimisë shpirtërore në hapësirën publike brenda Qendrës Historike. Projekti është pjesë e përpjekjeve të rregullta të organizatës për të integruar trashëgiminë kulturore në planifikimin zhvillimor të komunave të rajonit të Prizrenit.

Të arriturat kryesore të projektit gjatë vitit 2014 ishin:

- Realizimi i Javës së Trashëgimisë Shpirtërore në Prizren si përpjekje për t'i ruajtur dhe kultivuar praktikën shpirtërore të rajonit të Prizrenit,

- Vizita të rregullta për grupet e komunitetit për të ndërvepruar me praktikat shpirtërore të trashëgimisë kulturore në Prizren dhe qytetet e tjera të Kosovës,
- Konsolidimi i databazës së trashëgimisë kulturore të rajonit të Prizrenit si bazë kryesore e të dhënave mbi të cilën do të ndërtohet Strategjia rajonale e trashëgimisë kulturore.

Rritja e pjesëmarrjes qytetare përmes mediave sociale

Platforma e aktivizmit online Merr Pjesë ka vazhduar të pranojë raste nga qytetarët përmes katër moduleve të aktivizmit (ankohu, buxhetimi me pjesëmarrje, e-peticione dhe konsultime online). Të gjitha rastet e pranuar janë analizuar dhe dërguar në sektorët përkatës të komunës së Prizrenit. Gjatë vitit 2014, platformës iu është shtuar edhe moduli i katërt mbi konsultimet publike, në të cilin publikohen draftet e dokumenteve të komunës (plane urbane, buxhet, rregullore, etj.). Platforma e aktivizmit online ka nxitur një numër procesesh institucionale, duke ndikuar në vendime të autoriteteve komunale si reagim ndaj rasteve që janë dërguar nga qytetarët. Gjatë vitit 2015 do të synohet funksionalizimi i mëtejshëm i platformës Merr Pjesë, duke e rritur numrin e përdoruesve. Projekti synon të nxisë aktivizmin online si njëri ndër mjetet e organizimit të komunitetit dhe pjesëmarrjes në vendimmarrjen lokale. Gjatë vitit 2015 do të synohet zgjerimi i platformës edhe në komunat e tjera të rajonit të Prizrenit.

Të arriturat kryesore të projektit gjatë vitit 2014 ishin:

- Dhjetëra raste të raportuara nga qytetarët janë dërguar në sektorët përkatës të komunës së Prizrenit,
- Një numër i rasteve të raportuara kanë gjetura zgjidhje konkrete, derisa për një pjesë të tyre komuna ka ofruar zotime buxhetore në vitet vijuese,
- Mobilizim i komunitetit për aktivizëm online kryesisht përmes peticioneve elektronike.

PUBLIKIMET

Gjatë vitit 2014, organizata ka prodhuar 16 publikime, përfshi analiza, dokumente të politikave, raporte, studime hulumtuese, buletinë dhe video produkte.

Buletini i parë informativ "Gjykatë e hapur"

tetor, 2014

Publikimi i ri i Gjykatës Themelore të Prizrenit është një dritare e re e transparencës së punës së kësaj Gjykate, që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në punën e Gjykatës në veçanti. Ky publikim periodik do të ofrojë informacion mbi punën e gjykatës, statistikën e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen mediale, dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Newsletter 3 i partnerëve të OPIC-ut

tetor, 2014

Partnerët e Olof Palme International Center në Kosovë kanë publikuar numrin e tretë të newsletter (fletushkës INFORMATIVE) "Focus Kosovo". Kjo fletushkë përmbledh punën e organizatave partnere të OPIC-ut dhe zhvillimet e tjera në Kosovë që kanë të bëjnë me zhvillimin e kulturës, barazinë gjinore, pjesëmarrjen në vendimmarrje si dhe çështjet politike. Redaktor i këtij publikimi në emër të partnerëve të OPIC-ut është organizata EC Ma Ndryshe.

Planifikim urban për qytetarët 3

tetor, 2014

Për t'i vënë në pah shqetësimet e përditshmërisë së qytetarëve të Prizrenit, si dhe për të kuptuar se sa janë të njohur me procesin aktual të planifikimit dhe mundësitë e pjesëmarrjes qytetare në vendimet që lidhen me të, në qershor të këtij viti, u krye anketimi i tretë. Të gjeturat e anketimit u mbledhën nga një mostër e gjerë e popullatës së Prizrenit. Ky raport përmbledh të gjeturat dhe ofron rekomandime bazuar në problemet më kritike të identifikuara në anketim.

Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit

tetor, 2014

Raporti hulumtues mbi Qendrën Historike të Prishtinës, që ka për qëllim vetëdijësimin e komunitetit të gjerë për shkallën e degradimit të saj, nxjerrjen në pah të aktiviteteve të dëmshme në të dhe ngritjen e shqetësimit për të ardhmen e saj.

Newsletter 2 i partnerëve të OPIC-ut në Kosovë

gusht, 2014

Partnerët e Olof Palme International Center në Kosovë kanë vazhduar me publikimin e numrit të dytë të newsletter (fletushkës informative) "Focus Kosovo". Kjo fletushkë përmbledh punën e organizatave partnere të OPIC-ut dhe zhvillimet e tjera në Kosovë dhe do të publikohet çdo tre muaj. Redaktor i këtij publikimi në emër të partnerëve të OPIC-ut është organizata EC Ma Ndryshe.

Ku është kalldrëmi i Prizrenit?

gusht, 2014

Prizreni, si qendër urbane, prej shekujsh dallohet me karakteristikat arkitektonike të saj. Përgjatë historisë qyteti është ndërtuar me materiale tradicionale, në mesin e të cilave kalldrëmi përbën identitetin historik të rrugëve e rrugicave të tij. Si i tillë, kalldrëmi i ka dhënë karakter dhe hijeshi shesheve e rrugëve të Prizrenit në të kaluarën, dhe vazhdon ta bëjë këtë edhe sot e kësaj dite në pjesët e mbetura.

Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim?*korrik, 2014*

Ky raport shqyrton transparencën e komunave të Prizrenit dhe të Gjilanit në raport me të rinjtë. Analiza rrjedh nga hulumtimet e dyta të realizuara ndarazi me këtë kategori të shoqërisë, në këto dy komuna, në kuadër të projektit "Pjesëmarrja përmes medieve sociale", që është zbatuar përgjatë 15 muajve të kaluar në komunën e Prizrenit dhe gjatë një viti në komunën e Gjilanit.

Paraja publike si "paret e babes"*korrik, 2014*

Raporti i titulluar "Paraja publike si 'paret e babes'" përfshin punën katër mujore të OJQ-së EC Ma Ndryshe në monitorimin e transparencës në komunat e Prizrenit, Prishtinës dhe Mamushës.

Newsletter i partnerëve të OPIC-ut në Kosovë*qershor, 2014*

Partnerët e Olof Palme International Center në Kosovë kanë publikuar numrin e parë të newsletter (fletushkës informative) "Focus Kosovo". Kjo fletushkë përmbledh punën e organizatave partnere të OPIC-ut dhe zhvillimet e tjera në Kosovë dhe do të publikohet çdo tre muaj. Redaktor i këtij publikimi në emër të partnerëve të OPIC-ut është organizata EC Ma Ndryshe.

Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore*qershor, 2014*

EC Ma Ndryshe me ftesë të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë ka prezantuar analizën mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë në takimin konsultues të BE-së me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Raporti "Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore" u hartua me përkrahjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

Dokumentari - Sa aktiv, aq transparent?*qershor, 2014*

Dokumentari "Sa aktiv, aq transparent?" është realizuar në kuadër të projektit "Rritja e Pjesëmarrjes përmes Mediave Sociale", i përkrahur financiarisht nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Projekti SMILE i financuar nga Democratic Governance Thematic Trust Fund (DGTTF). Projekti është zbatuar nga EC Ma Ndryshe

Udhëzues për Transparencën në Komuna*prill, 2014*

Organizata jo-qeveritare EC Ma Ndryshe e ka hartuar këtë dokument me qëllim të prezantimit të obligimeve dhe detyrimeve ligjore të pushtetit lokal për transparencë dhe llogaridhënie. Krahas kësaj, me anë të këtij dokumenti synohet të jepet një pasqyrë e gjendjes në komuna, në kuptim të zbatimit të obligimeve dhe detyrimeve të komunave në fushën e transparencës dhe llogaridhënies.

Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike*prill, 2014*

Shteti i Kosovës ka kornizë legjislative dhe institucionale shumë të favorshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mirëpo degradimi që po ndodh është tregues i dështimit institucional për të mbrojtur Qendrën Historike të Prizrenit dhe konfirmim i konstatimit se ligjet janë të pamjaftueshme për të siguruar rend urbanistik. dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore në këtë qendër.

Qendra Historike e Prizrenit, Zonë e (Pa)Mbrojtur*mars, 2014*

Raporti i titulluar “Qendra Historike e Prizrenit, Zonë e (Pa)Mbrojtur” përmban brenda vetes punën gjashtë mujore (gusht 2013- janar 2014) të monitorimit të zhvillimeve në sektorin e Urbanizmit brenda komunës së Prizrenit, në kuadër të projektit “Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”.

Urbanizmi si lexim i qytetit*mars, 2014*

Qyteti i Prizrenit ka ardhur në jetë pa ndihmën e projektuesve dhe është formësuar duke u adaptuar me jetën e përditshme të qytetarëve. Beteja në mes të këtij adaptimi (urban) pra të asaj që vjen me ate që shkon e krijon pamjen aktuale të qytetit.

Qyteti Gjithëpërfshirës*janar, 2014*

Ky publikim përmbledh raportet e shtatë ekspertëve, detyra e të cilëve ishte t’i strukturojnë të gjeturat e një cikli të gjatë hulumtues dhe t’i paraqesin ato në formë të dokumenteve udhëzuese për qeverinë lokale të Prizrenit, si kontribut për procesin e planifikimit urban.

RRJETËZIMI

Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren (RrOK Prizren), është rrjet joformal i organizatave të kulturës në komunën e Prizrenit. Misioni i këtij Rrjeti është arritja e një ekonomie të zhvilluar lokale në Prizren përmes pasurimit dhe strukturimit të ofertës turistike bazuar në rritjen e cilësisë dhe vëllimit të aktiviteteve kulturore. Momentalisht, EC Ma Ndryshe kordinon sekretariatit e Rrjetit përmes të cilit në bashkëpunim me organizatat tjera anëtarë, është i angazhuar në një dialog të strukturuar me qeverinë lokale të Prizrenit për të nxitur zhvillimin e politikave lokale kulturore.

Paralelisht me punën e saj në politikat lokale kulturore, EC Ma Ndryshe është njëra nga themelueset e **Forumit Kulturor** (Rrjeti i organizatave të pavarura kulturore të Kosovës), i cili promovon politikat kulturore në nivelin qendror. Aktiviteti konkret i Forumit Kulturor është avokimi për Strategjinë Shtetërore Kulturore të Kosovës, si një dokument udhërrëfyes për zhvillimin e politikave kulturore.

EC Ma Ndryshe është anëtare dhe njëra nga themelueset e rrjetit më të fuqishëm rajonal të trashëgimisë kulturore **South East European Heritage Network**. Anëtare të këtij rrjeti janë organizatat më të fuqishme të shteteve të Ballkanit që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është aktive në projekte të bashkëpunimit rajonal, të cilat kanë lindur nga veprimtaria e rrjetit dhe bashkëpunon me një numër të madh organizatash rajonale.

Gjithashtu, EC Ma Ndryshe është anëtare e **Platformës Civikos**, rrjetit më të madh të organizatave jo-qeveritare që janë të angazhuara në dialogun mes sektorit të shoqërisë civile dhe qeverisë.

DONATORËT

Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë së EC, Ma Ndryshe përkrahet nga institucionet dhe organizatat donatore. Ndhimja e tyre është mjaft e rëndësishme në qëndrueshmërinë institucionale të organizatës dhe në përmbushjen e misionit të saj.

Donatorët që na kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të na ndihmojnë:

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)

Trashëgimia Kulturore pa Kufij, zyra në Prishtinë (CHwB Prishtina)

Ambasada Amerikane në Prishtinë

USAID Kosovë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

Komisioni Evropian

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K)

Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë

Olof Palme International Center (OPIC)

Rockefeller Brothers Fund (RBF)


United Nations Development Program Kosova (UNDP)

British Council, zyra në Prishtinë


Këshilli i Evropës, zyra në Kosovë

National Endowment for Democracy përmes YIHR Kosovë

Raporti vjetor i punës për vitin 2014 u miratua në takimin vjetor të Kuvendit të Anëtarëve të EC Ma Ndryshe, mbajtur më 24 Janar 2015, në Prizren


Në emër të Kuvendit të Anëtarëve
Kreshnik Basha, kryesues i Kuvendit të Anëtarëve




Në emër të stafit të organizatës
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv